

---

## **PLANPROGRAMI I SPECIALIZIMIT NGA KIRURGJIA ORALE**

---

Specializimi zgjatë 36 muaj.

KIRURGJIA E PËRGJITHËSHME	3 muaj
OTORINOLARINGOLOGJIA	2 muaj
KIRURGJIA MAXILLOFACIALE	7 muaj
KIRURGJIA ORALE	21 muaj
PUSHIMI VJETOR	3 muaj

**KIRURGJIA E PËRGJITHËSHME            3 muaj**

---

Kirurgu oral duhet të njoh dhe të mësojë metodat bashkëkohore të desinfektimit dhe sterilizimit të hapësirës, instrumenteve, materialeve, dhe të dijë të bëjë desinfektimit e fushës operative.

Duhet të mësojë përgatitjen preoperative dhe të caktoj mënyrën dhe llojin e kujdesit postoperativ të të sëmurit. Duhet të dijë të ndalë çdo gjakderdhje nga plaga e hapur dhe të bënë përpunimin primar, definitiv apo të përkohshëm.

Duhet të mësojë të njohë shenjat dhe simptomatologjin e shokut traumatic, të dijë të përcjellë zhvillimin e tablos klinike të sëmuarit të neurotraumaizuar. Duhet të mësojë të njohë pasqyrën e tronditjes së trurit dhe mënyrën e shërimit, pasqyrën e kontuzionit të trurit, pasqyrën e sindromit kompresiv dhe të njihet me metodat diagnostike dhe mënyrën e shërimit kirurgjik. Duhet të njihet me parimet e përgjithëshme të kirurgjisë plasike dhe parimet themelore të shërimit kirurgjik të tumoreve beninje dhe malinje.

Duhet të mësojë principet themelore të dhënjes së ndihmes së pare, të reanimimit dhe trajtimin e traumave në kushte të luftës dhe në paqë.

Në fund të punës tremujore I nënshtrohet **kollokviumit**.

## **OTORINOLARINGOLOGJIA**

**2 muaj**

---

Specializanti i kirurgjisë orale duhet të njohë anatominë, fiziologjinë dhe patofiziologjinë e regjionit të veshit, fytit dhe hundës. Gjatë qëndrimit në ORL duhet të dijë të përdorë pasqyrën e ballit, të bëjë ekzaminimet themelore otorinolaringologjike: rinoskopinë, otoskopinë, rinoskopinë e pasme, laringoskopinë indirekte, sinusoskopinë etj.

Duhet të mësojë simptomet, tabllon klinike dhe shërimin e inflamacioneve acute dhe kronike të regjionit gjegjës, e sidomos thelbin e problemit tonsillar.

Duhet të mësojë patogjenezën, simptomet, tabllon klinike dhe terapinë e inflamacioneve të sinusit dhe komplikimet e mundëshme. Duhet të mësojë Duhet të mësojë simptomatologjinë e tumoreve malinje të sinusit maksillar, përhapjen e tumorit dhe mundësinë e shërimit. Duhet të mësojë përpunimin kirurgjik të sinusit me të gjitha metodat e njohura, të largoj trupin e huaj nga sinusi dhe të mbyllë komunikimin oroantral jatrogjen akut dhe kronik. Gjatë stazhit specialistik duhet të bëhen deri në pesë intervenime të tilla.

Duhet të mësojë tamponadën e përparme dhe të pasme të hundës, me orientim të shkaktarëve etiologjik të epistaksës Në raste të gulfatjes acute duhet të dijë të bëjë kohotominë dhe traheotominë, e që të dijë ta bëjë këtë, gjatë stazhit specialistik, duhet të bëjë deri në pesë traheotomi.

Në fund specializanti i nënshtrohet kollokviumit

**Infekcionet në kirurgji:**

Spacializanti duhet të dijë të definoj dhe të mësoj të diagnostifikoj infekcionet putride dhe të gjitha llojet e infeksioneve specifike( tuberkulozin, aktinomikozën, luesin). Duhet të mësojë metodat konservatve dhe kirurgjike të shërimit të infeksioneve putride dhe specifike të regjionit të fytyrës , nofullave dhe gojës.

**Traumatologjia:**

Duhet të mësojë të diagnostifikoj lëndimet e hapura dhe të mbyllura të fytyrës dhe trajtimin e tyre konservativ dhe kirurgjik.

Duhet të mësojë të diagnostifikoj dhe të trajtoj në mënyrë konservative dhe kirurgjike frakturat e izoluar dhe të kombinuara të kockës së fytyrës(kocka e hundës, kocka zigomaikë dhe harku zigomatik, dyshemeja e orbitës, maksilla dhe mandibulla) dhe për këtë qëllim duhet të bëjë dhjetë osteosinteza të kockave të thyera

Duhet të mësojë të diagnostifikoj lëndimet frontoetmoidale, të vërtetoj prezencën e likuorit, otorenë eventuale dhe të ndërmerr ndërhyrjen themelore të ndihmës së pare.

Duhet të mësojë shkaktarët e lëndimeve postraumatike dhe mënyrën e shërimit.

Pasi të zotëroj problematikën e infeksioneve në kirurgji dhe traumatologjinë, specializanti i nënshtrohet **kolokviumit**

**Malformacionet kongjenitale:**

Specializanti i kirurgjisë orale duhet të mësojë patogjenezën , faktorët etiologjik dhe definicionin e çarjeve të buzës , nofullës dhe qiellzës. Duhet të dijë qëndrimin e përgjithshëm, tretmanin dhe terminet e ndërhyrjeve kirurgjike.. Duhet t'i njohë bazat e përgjithshme të ndërhyrjeve kirurgjike dhe të dijë pasojat e veprimeve të gabuara. Duhet të dijë t'i këshilloi prindët për mënyrën e ushqimit të fëmiut, nevojën e shërimit afatgjatë dhe bashkëpunimin me ekipën e specialistëve (kirurgu maksillofacial, ortodonti, proteticienti, foniatri dhe logopedi)

Duhet të mësoi t'i njohë anomalitë tjera dhe sindromet e nofullave dhe fytyrës dhe të dijë mënyrën e shërimit të tyre. Duhet të njohë bazat e shërimit kirurgjiko-ortodontik dhe të mësoi metodat operative për rekonstruimin e raportit mes nofullave dhe dhëmbëve.

### **Gjëndrrat pështymore:**

Specializanti duhet të mësoi të diagnostifikoi inflamimet akute, kronike, dhe ndryshimet degjenerative të gjëndrrave të pështymës dhe mundësin e shërimit kirurgjik të tyre. Duhet të mësojë të diagnostifikoi sialolitiazën, largimin e sialolitit nga kanali i gjëndrës dhe duhet të mësoi të largoi gjëndrën submandibulare. Për këtë qëllim duhet të mësoi dy operacione të tilla.

### **Kistat dhe tumoret e qafës:**

Specializanti duhet të mësoi të diagnostifikoi formacionet kistike dhe tumorale në regjionin e qafës dhe me kohë të udhëzoi të sëmuarin në shërimin specialistik gjegjës.

### **Nervi facial (n. facialis):**

Specializanti duhet të mësoi të diagnostifikoi dhe të njohë shkaktarët etiologjik si dhe mënyrën e shërimit të pareses së n. facial, të mësoi bazat e shërimit konservativ dhe kirurgjik të pareses së nervit facial dhe mundësitë e rekonstruimit të nervit.

### **Onkologjia:**

Specializanti duhet të mësoi lokalizimet më të shpeshta të tumorreve malinje të fytyrës, nofullave, gjëndrrave pështymore, buzëve dhe hapësirës së gojës. Duhet të njohë etiologjinë, diagnostikën, tipet histologjike të tumorreve malinje, përhapjen, mënyrën e shërimit dhe prognozën e sëmundjes.

Me qëllim të diagnostifikimit të hershëm specializanti i kirurgjisë orale duhet të mësoi të bëjë ekscizionin probatorë të çdo lezionit suspekt në hapësirën e gojës, të merr strishon për analizë citologjike dhe të bëjë punkcionin nga lezionet suspekte. Duhet të mësoi të interpretoi rezultatet patohistologjike, citologjike dhe nga punkcioni.

Specializanti duhet të mësoi të diagnostifikoi dhe të shëroi pasojat intraorale të terapisë radiologjike dhe citostatike. Duhet të mësoi bazat e punimit të protezave resekcionuese dhe epitezave dhe mundësinë e retencionit të tyre deri te përdorimi i implantateve ekstraorale osteointegruese.

Pas mbizotrimin të këtij programi specializanti i nënshtrohet **kollokviumit**.

## KIRURGJIA ORALE -21 muaj

---

Specializanti i kirurgjisë orale gjatë perfeksionimit në kirurgjinë orale duhet të mësoi teknikën e aplikimit të gjitha anesteziave lokale, posaqërisht atyre përcjellëse në regjionin e hapësirës së gojës, fytyrës dhe qafës. Të mësoi komplikimet lokale dhe të përgjithshme të cilat mund të zhvillohen gjatë dhe pas dhënjes së anestezionit lokal (reakcionet toksike dhe alergjike në anestetik lokal dhe reacionet në vazokonstriktor) Duhet të mësoi metodat themelore dhe teknikën e reanimimit të të sëmurit në rrezik jete (regullimin e frymmarrjes dhe qarkullimit të gjakut.

Duhet të mësoi shkaktarët etiologjik, rrugët e përhapjes,shërimin konservativ dhe kirurgjik pastaj komplikimet të infeksioneve acute qelbore në hapësirën e gojës dhe farinksit gjegjësisht fytit. Duhet të mësoi shkaktarët ,shërimin konservativ dhe kirurgjik pastaj komplikimet e infeksioneve kronike të indeve të buta dhe kockkave të fytyrës (osteomieliti).

Duhet të mësoi dhe zotëroi të gjitha tenikat kirurgjike të regjionit të dhëmbëve dhe parodontit dhe për këtë qëllim të nxjerrë numër të madh të dhëmbëve ,30 avleotomi, 10 replantime dhe transplantime të dhëmbëve, 5 fiksime transdentale të dhëmbëve me omplante, 10 kortikotomi,10 kontrollome të dhëmbëve të ekstruduar, 5 gingivektomi.Duhet të mësoi ti parasheh dhe sanoi të gjitha komplikimet e mundëshme gjatë apo pas këtyre intervenimeve.

Pas mbizotrimt të këtij programi specializanti i nënshtrohet **kollokviumit** nga kirurgjia dentale.

Duhet të mësoi dhe zotëroi të gjitha metodat dhe tenikat kirurgjike të shërimit të kistave odontogjene dhe joodontogjene të nofullave dhe indeve të buta të hapësirës së gojës.

Duhet të mësoi indikacionet dhe diagnozën e drejtë për intervenim kirurgjik paraprotetikor,si dhe tretmanin kirurgjik përkatës.:modelimin e tuberave,vestibuloplastika me mukozë lokale, vestibuloplastika me transplantat me mukozë apo lëkurë, osteoplastika.Për këtë qëllim duhet të bënë së paku 10 modelime të pragut alveolar, 5 vestibuloplastika me llambo lokale me mukozë dhe 2 vestibuloplastika me transplantat mukozal apo me lëkurë.Gjithashtu duhet të merr pjesë te intervenimet e augmentimit të nofullës me autotransplant apo alotransplant. Duhet të mësoi të preparoi dhe të marr transplantet nga mukoza apo lëkura, ndërsa për transplantet kockore duhet të kërkoi bashkpunimin me kirurgun maxillofacial.

Duhet të mësoi të korigji në mënyrë kirurgjike të gjitha anomalit dhe deformimet e indeve të buta dhe të forta në terapinë preprotetikore dhe preortodontike.

Specializanti duhet të mësoi bazat themelore, teknikat operative dhe mundësinë e rehabilitimit protetikor me implante dentare.Duhet të njohë konceptin e osteointegrit të

aloimplanteve, rëndësinë e bashkpunimit me proteticientin në planifikimin e rehabilitimit imlanto-protetikor,duhet të mësoi kriteret e indikacioneve dhe kontraindikacioneve për aplikimin e implanteve dentare osteointegruese, duhet të zotëroi teknikën operative të mbjelljes së implanteve dentare osteointegruese dhe duhet të dijë në mënyrë konstruktive të merr pjesë në rehabilitimin protetikor.Duhet të mësoi principet themelore të regjenerimit të kockës.

Specializanti duhet të mësoi shërimin konservativ dhe kirurgjik të lëndimeve të dhëmbëve : aparatit mbështetës të dhëmbit.

Specializanti duhet të mësoi ti njohë të gjithë tumorret në hapësirën e gojës qoftë ata beninj ose malinj. Duhet të zotëroi të gjitha teknikat operative të largimit të tumorreve beninje në hapësirën e gojës dhe ti kryej së paku tri operacione të tilla.

Specializanti duhet të njohë patologjinë dhe diagnostikën e gjendjeve patologjike të nyjes temporo-mandibulare dhe të mësoi mundësitë e terapisë konzervetive dhe protetikore të patologjive në regjionin e nyjes temporo-mandibulare. Duhet të mësoi sëmundjet më të shpeshta të nyjes TM, e këto janë disfunkcioni dhe sindromi miofacial i dhembjes dhe sipas nevojës të bashkëpunoj me specialistat e lëmive tjera( ortopedi, reumatologu, proteticienti, fiziatri). Duhet të dijë të vendosë indikacionet për .....

Duhet të mësoi të diagnostifikoi dhe ti shëroj në mënyrë kirurgjike ndrrimet në gjëndrrat e vogla pështymore, dhe në rastet suspekte të egzaminimit patohistologjik të kërkoj bashkëpunimin e specialistit përkatës.Duhet të mësoi të bënë sialografinë e gjëdrave të mëdha pështymore dhe gjatë stazhit specialistik të bëjë së paku pesë ndërhyrje të tilla.

Duhet të mësoi të diagnostifikoi dhe ti shëroj në mënyrë kirurgjike neuralgjite e degës së dytë dhe të tretë të n.trigeminal. Gjithashtu duhet t'i mësoi metodat operative dhe teknikat e amputimit periferik të nervit të sëmurë dhe me këtë qëllim t'i kryej dy neuroexaereze.

Specializanti është i obliguar që t'i përcjell dy semestra të mësimit teorik nga lëmia e Kirurgjisë orale.